

 TRAINKOS SH.A.  
TRAINKOS D.D.  
TRAINKOS J.S.C.  
Nr.No.Br. 7/14  
Dt. 31.01.2024  
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje



**trainkos**

**HEKURUDHAT E KOSOVËS**

## **RREGULLORE**

**PËR MIRËMBAJTJEN E MJETEVE LËVIZËSE HEKURUDHORE NË  
HEKURUDHAT E KOSOVËS-TRAINKOS SH.A.**

**Fushë Kosovë  
Janar 2024**

# PËRMBAJTJA

<b>I</b>	<b>Dispozitat e përgjithshme.....</b>	<b>4</b>
	Lënda e Rregullores.....	4
	Zbatimi i Rregullores.....	4
<b>II</b>	<b>Dispozitat e përbashkëta.....</b>	<b>5</b>
	Parimet e përgjithshme të mirëmbajtjes.....	5
	Testimi dhe verifikimi.....	6
	Llojet e mirëmbajtjes.....	6
	Definicioni i disa llojeve të mirëmbajtjes.....	7
	Afatet e mirëmbajtjeve të rregullta.....	8
	Renditja dhe afatet për riparimet e rregullta.....	8
	Ndarja e punëve të mirëmbajtjes.....	9
	Vëllimi i mirëmbajtjes së rregullt.....	10
	Modifikimi dhe rikonstruktimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore.....	11
	Dokumentacioni teknik për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizës hekurudhore.....	12
	Aftësimi i personelit për punë në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse.....	13
	Parakushtet për organizimin e rregullt të mirëmbajtjes.....	13
	Përgatitja dhe dorëzimi i mjetit lëvizës për riparim të rregullt në punëtori.....	14
	Mënyra e kryerjes së riparimit të mjeteve lëvizëse hekurudhore.....	14
	Mirëmbajtja e stabilimenteve të sigurisë në mjetin lëvizës.....	15
	Kontrolli mbi cilësinë e riparimit.....	15
	Balancimi (peshimi) i mjetit lëvizës pas riparimit.....	16
	Vozitja provuese e mjetit lëvizës hekurudhor pas riparimit.....	16
	Pranimi i mjetit lëvizës hekurudhor pas riparimit.....	17
	Garancioni për kualitetin e riparimit.....	17
	Mbajtja e shënimeve për mirëmbajtjen e mjetit lëvizës hekurudhor.....	17
<b>III</b>	<b>Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.....</b>	<b>18</b>

## ANEKSET

<b>Aneks 1</b> .....	20
<b>Mirëmbajtja e mjeteve tërheqëse</b> .....	20
Mbikëqyrja e vazhdueshme.....	20
Larja dhe pastrimi.....	21
Servisimi.....	21
Kontrollimi.....	22
Riparimi i rregullt.....	24
<b>Aneks 2</b> .....	27
<b>Procedura për kryerjen e kontrollimit për vazhdimin e afatit të riparimit të rregullt të mjetit lëvizës hekurudhor</b> .....	27
<b>Aneks 3</b> .....	28
<b>Mirëmbajtja e vagonëve të udhëtarëve</b> .....	28
a) Mirëmbajtja e rregullt e vagonëve të udhëtarëve.....	28
Mbikëqyrja e vazhdueshme.....	28
Larja, pastrimi dhe dezodorantizimi.....	28
Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi.....	28
Kontrollimi.....	29
Riparimi i rregullt.....	29
Renditja dhe afati i riparimeve të rregullta.....	30
b) Riparimi i jashtëzakonshëm i vagonëve të udhëtarëve.....	31
<b>Aneks 4</b> .....	32
<b>Mirëmbajtja e vagonëve të mallrave</b> .....	32
a) Mirëmbajtja e rregullt e vagonëve të mallrave.....	32
Kontrollimi.....	32
Riparimi i rregullt.....	32
Renditja dhe afati i riparimeve të rregullta.....	33
b) Riparimi i jashtëzakonshëm i vagonëve të mallrave.....	36
<b>Aneks 5</b> .....	37
<b>Procedura për kryerjen e kontrollimit për vazhdimin e afatit të riparimit të rregullt të vagonëve</b> .....	37
<b>Aneks 6</b> .....	38
<b>Procedurat me mjetin lëvizës hekurudhor pas rastit të jashtëzakonshëm</b> .....	38

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-111 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të Nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Koorporative për NP, Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A. në Mbledhjen Nr. 02, të mbajtur më 31.01.2024, miraton këtë:

## **RREGULORE**

### **Për Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore në HK-Trainkos Sh.A**

#### **I. Dispozitat e përgjithshme**

##### *Lënda e Rregullores*

##### **Neni 1**

1. Në Rregulloren për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore (në tekstin vijues Rregullorja) caktohet mënyra dhe kushtet e mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse hekurudhore në Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A.
2. Nëse ndonjë çështje, e cila ka të bëjë me fushën e mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse hekurudhore nuk është paraparë në këtë Rregullore, atëherë veprohet sipas rregullave ndërkombëtare për mirëmbajtjen e tyre.
3. Nëse rregullat e tilla nuk ekzistojnë atëherë veprohet sipas udhëzimeve adekuate të nxjerra enkas për këto punë në Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A.

##### *Zbatimi i Rregullores*

##### **Neni 2**

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje vlejné për këto mjete lëvizëse hekurudhore në HK-Trainkos Sh.A për:
  - a) **Lokomotiva;**
  - b) **Trena motorikë;**
  - c) **Vagonë të udhëtarëve;**
  - d) **Vagonë të mallrave.**

## II. Dispozitat e përbashkëta

### *Parimet e përgjithshme të mirëmbajtjes*

#### Neni 3

1. Mirëmbajtja e mjeteve lëvizëse hekurudhore është një proces i përhershëm i cili duhet të ofrojë siguri, shfrytëzim ekonomik dhe të besueshëm të mjeteve lëvizëse hekurudhore në transportin publik hekurudhor. Ky lloj i mirëmbajtjes ka karakter parandalues. Lloji dhe renditja e mirëmbajtjes caktohet paraprakisht përbrenda kontrollimeve periodike dhe riparimeve të rregullta. Rënditja e këtyre kontrollimeve dhe riparimeve caktohet sipas gjendjes së pjesëve dhe nyjave në mjetet lëvizëse hekurudhore gjatë eksploatimit siç është përshkruar në anekset e kësaj Rregulloreje.
2. Në rastet e riparimit të jashtëzakonshëm të mjetit lëvizës përmbushet edhe afati i riparimit të rregullt nëse në riparim të jashtëzakonshëm janë përfshirë të gjitha punët e parapara në riparimin e rregullt.
3. Mjetet lëvizëse hekurudhore mirëmbahen në punëtoritë apo kompanitë të cilat me pajisjet e tyre dhe kuadrin profesional mundësojnë riparimin kualitativ të mjeteve lëvizëse hekurudhore.
4. Mirëmbajtja e mjeteve lëvizëse hekurudhore duhet të organizohet në atë mënyrë që mjetet lëvizëse hekurudhore të jenë sa më pak që është e mundur jashtë operimi, pa e vënë në pyetje cilësinë e punës.
5. Kushtet bazë gjatë organizimit të mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse hekurudhore janë:
  - a) Përgatitja e dokumentacionit teknik për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore për përdorim të drejtpërdrejtë në punëtori dhe reparte.
  - b) Caktimi i llojeve, cikleve të mirëmbajtjes si dhe renditja e operacioneve të mirëmbajtjes.
  - c) Plotësimi i rregullave në bazë të përcjelljes së vazhdueshme të gjendjes së mjeteve lëvizëse hekurudhore në operim dhe para kryerjes së riparimit. Punët në mirëmbajtje duhet t'i përshtaten konsumimit dhe dëmtimit të vërtet të pjesëve apo nyjave në mjetet lëvizëse hekurudhore.
  - d) Përmbajtja e afateve të caktuara dhe cilësisë së punëve për ndonjë lloj të riparimit të rregullt.
  - e) Cilësia e punëve në mirëmbajtje dhe materiali i vendosur në mjetin lëvizës hekurudhor duhet të sigurojnë kualitet në punët e kryera.
  - f) Shfrytëzimi optimal të kohës së punës dhe materialeve për kryerjen e punëve në mirëmbajtje.
  - g) Sigurimi me kohë i pjesëve të ndërrimit të nevojshëm për ndërrimin e pjesëve të konsumuara dhe një numri të caktuar të nyjave për ndërrim me qëllim të

organizimit të riparimit të mjetit lëvizës hekurudhor sipas sistemit të remontit industrial.

- h) Përdorimi i pjesëve origjinale, të prodhuara apo riparuar sipas dokumentacionit teknik të vërtetuar nga autoritetet kompetent nga Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A.
- i) Punëtorja e specializuar për kryerjen e riparimeve të serive të caktuara apo nyjave dhe stabilimenteve të caktuara.

### ***Testimi dhe verifikimi***

#### **Neni 4**

1. Për konstatimin e gjendjes së pjesëve, nyjave dhe pajisjeve në mjetet lëvizëse hekurudhore, konsumimin dhe dëmtimin e tyre si dhe konstatimin e gjendjes së tyre me kalimin e kohës duhet të bëhen testimet përkatëse dhe verifikimet. Këto teste dhe verifikime mundësojnë që të fitohen të dhëna të caktuara të cilat shërbejnë për caktimin e renditjes dhe afateve për kryerjen e kontrollimeve periodike dhe riparimeve të rregullta dhe për caktimin e vëllimit të punës së tyre.
2. Testimin dhe verifikimin, kur për të ka nevojë e organizon autoriteti kompetent në Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. në bashkëpunim me personelin e punëtorisë, e cila i mirëmban mjetet lëvizëse hekurudhore e që vlen për këto raste:
  - a) Te riparimi i rregullt i parë në llojet e reja të mjeteve lëvizëse;
  - b) Te aplikimi i kontrollimit periodik fillestar apo riparimit të rregullt fillestar;
  - c) Te ndryshimi i afatit për ndonjë lloj të riparimit të rregullt;
  - d) Te ndryshimi i vëllimit të punës për ndonjë lloj të riparimit të rregullt.

### ***Llojet e mirëmbajtjes***

#### **Neni 5**

1. Mirëmbajtja e mjeteve lëvizëse mund të jetë:
  - a) E rregullt;
  - b) E jashtëzakonshme.
2. Në mirëmbajtjen e rregullt bëjnë pjesë:
  - a) Larja, pastrimi dhe dezodorantizimi;
  - b) Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi (te vagonët e udhëtarëve);
  - c) Servisimi (të mjetet tërheqëse);
  - d) Kontrollimi periodik;

- e) Riparimet e rregullta.
3. Në mirëmbajtjen e jashtëzakonshëm bëjnë pjesë:
- a) Larja dhe pastrimi (te vagonët e mallrave);
  - b) Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi (te vagonët e mallrave);
  - c) Riparimet e jashtëzakonshme për shkak të prishjeve, konsumimeve dhe dëmtimeve me forcë.
4. Mbikëqyrja apo kujdesi i përhershëm i mjeteve lëvizëse hekurudhore nuk bënë pjesë direkt në mirëmbajtjen e rregullt, por pasi që ka lidhje të drejtpërdrejt me mjetet lëvizëse hekurudhore dhe ndikon në gjendjen e tyre në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje është sqaruar mënyra e kryerjes së tyre.

### ***Definicioni i disa llojeve të mirëmbajtjeve***

#### **Neni 6**

1. Me larje dhe pastrim të mjeteve lëvizëse nënkuptojmë largimin e papastërtisë nga brenda dhe jashtë;
2. Me dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim të vagonëve nënkuptojmë zhdukjen e baktereve infektuese, bacileve dhe baktereve, insekteve dhe brejtësve, ndërsa dezodorantizimi nënkupton largimin e aromave kundërmuese.
3. Me mbikëqyrje apo kujdes të përhershëm nënkuptojmë shikimin e rregullt teknik të mjetit lëvizës sipas mënyrës së përshkruar në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje, e cila është në përputhje me direktivat e Rregullores mbi Tërheqjen e Trenave dhe me direktivat e kësaj Rregulloreje.
4. Me servisim të mjeteve lëvizëse hekurudhore nënkuptojmë kontrollimin e nyjave dhe pajisjeve në mjetet lëvizëse hekurudhore, posaçërisht të atyre që janë të rëndësishme për sigurinë e operimit. Servisimi kryhet gjatë shfrytëzimit të mjetit lëvizës hekurudhor (në mes të dy trenave) në hapësirën e paraparë për servisim.
5. Me kontrollim të mjeteve lëvizëse hekurudhor nënkuptojmë shikimin dhe kontrollimin e pjesëve që konsumohen, verifikimin e rregullt të punës dhe kryerjen e funksioneve të pjesëve, nyjave dhe pajisjeve të caktuara si dhe ndërrimin e pjesëve të dëmtuara, materialeve të konsumuara të parapara për çdo lloj të kontrollimit dhe seri të automjetit.
6. Në kuadër të kontrollimeve kryhen edhe pastrimet, larjet dhe lubrifikimet e mjeteve lëvizëse hekurudhore si dhe të pjesëve dhe pajisjeve të tyre.
7. Me riparim të rregullt të mjeteve lëvizëse hekurudhore nënkuptojmë shikimin, kontrollimin dhe riparimin e të gjitha pjesëve, nyjave dhe pajisjeve apo i një numri të caktuar të tyre për ta sjell mjetin lëvizës hekurudhor teknikisht në gjendje të rregullt në përputhje me punët e parapara për çdo lloj të riparimit.
8. Me riparim të jashtëzakonshëm të mjeteve lëvizëse hekurudhore nënkuptojmë riparimin e ndonjë pjese, nyje apo pajisje për të eliminuar prishjen (dëmtimin) e lajmëruar gjatë

operimit, i cili është vërejtur nga personeli, gjithashtu për të eliminuar dëmtimet në mjetin lëvizës hekurudhor të shkaktuara gjatë aksidenteve (ndeshjeve, rrëshqitjeve nga binaret, zjarreve etj.).

9. Me dëmtim të mjeteve lëvizëse hekurudhore kuptojmë dëmtimin e pjesëve, nyjave dhe pajisjeve të cilat janë rezultat i aksidenteve, rrëshqitjeve nga binaret, vendosjes jo të drejt, ngarkimit dhe shkarkimit dhe të ngjashme.

Riparimi i mjeteve lëvizëse në këto raste nuk duhet lidhet me riparimet e rregullta vetëm në rastet kur vëllimi i punëve për riparim është më i madh apo i njëjtë me vëllimin e punëve të riparimit të rregullt.

### ***Afatet e mirëmbajtjeve të rregullta***

#### **Neni 7**

1. Plotësimi i kushteve për riparim të rregullt të mjeteve lëvizëse hekurudhore mbështet në parametrat si: koha e shfrytëzimit (kalendarik), kilometrave të kaluara, shpenzimeve të karburantit (numri i orëve të punës së dizel motorit) apo ndonjë matje tjetër sipas llojit dhe serisë së mjetit lëvizës hekurudhor.
2. Masë për caktimin e afateve për kryerjen e kontrollimeve të mjeteve lëvizëse hekurudhore është koha e shfrytëzimit, orët e punës së dizel motorit, si dhe kilometrat e kaluara nga kontrollimi i fundit (tabela 3,4 dhe 5 në Aneksin 1).
3. Masë për kryerjen e riparimeve të rregullta të mjeteve tërheqës është puna e kryer e shprehur në kilometrat e kaluara, shpenzimeve të karburantit apo orëve të punës të dizel motorit të llogaritura nga riparimi rregullt i fundit. Masa e cila nuk guxon të tejkalohet janë kilometrat e kaluara të shfrytëzimit të mjetit tërheqës pas riparimit të fundit të rregullt sipas përcaktimit në këtë rregullore.
4. Masë e afateve për riparimin e rregullt të vagonëve është:
  - a) Për vagonë të udhëtareve kilometrat e kaluar dhe koha e shfrytëzimit;
  - b) Për vagonë të mallrave koha e shfrytëzimit.

### ***Renditja e afateve për riparime të rregullta***

#### **Neni 8**

1. Me renditje të mirëmbajtjes së rregullt të mjeteve lëvizëse hekurudhore kuptojmë renditjen e riparimeve të rregullta të mjeteve lëvizëse hekurudhore sipas llojeve të kontrollimeve.
2. Mjetet lëvizëse hekurudhore të çdo serie mund të jenë në operim deri në riparimin e ardhshëm të rregullt pa numër të madh të riparimeve të jashtëzakonshme.



3. Renditja dhe afatet për mirëmbajtje të rregullt janë paraqitur në anekset e kësaj rregulloreje për çdo lloj dhe seri të mjeteve lëvizëse veç e veç.
4. Përshkrimi i riparimit të rregullt (përshkrimi i punëve) veç e veç për çdo lloj dhe seri të mjeteve lëvizëse hekurudhore është definua me Udhëzimin për kontrollime periodike dhe riparimet e rregullta të mjeteve lëvizëse hekurudhore.
5. Varësisht nga posedimi i objekteve dhe hapësirës për mirëmbajtje si dhe nga nevoja e shfrytëzimit të mjeteve lëvizëse hekurudhore gjegjëse, tejkalimi i afateve të caktuara për kryerjen e ndonjë lloji të mirëmbajtjes së rregullt lejohet nën kushtin e përmendur në aneksin 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje.
6. Nëse gjendja teknike e mjetit lëvizës hekurudhor është e tillë që pamundëson operimin e tij të sigurt dhe mirëmbajtje ekonomike, apo kërkon riparim të jashtëzakonshëm, atëherë ai mjet lëvizës hekurudhor duhet të dërgohet para kohe në riparimin e rregullt të radhës të paraparë sipas kësaj rregulloreje. Vendimin për dërgimin në riparim të jashtëzakonshëm të mjetit lëvizës e merr autoriteti i HK-Trainkos Sh.A në bazë të gjendjes teknike të konstatuar nga komisioni.  
Procedurën për shkurtimin e afatit për riparimet e rregullta të mjeteve tërheqëse në përputhje me pikën 1 të këtij neni e **cakton komisioni i cekur** në aneksin 2 të kësaj Rregulloreje.
7. Nëse mjeti lëvizës hekurudhor ka qenë jashtë operimi, kontrollimi i ardhshëm sipas renditjes bartet për kohën e qëndrimit të mjetit lëvizës hekurudhor jashtë operimi. Pas lëshimit në operim të mjetit lëvizës hekurudhor varësisht nga koha e qëndrimit dhe kushtet e garazhimit, kur ka qenë jashtë operimi, duhet të kryhet kontrollimi sipas vëllimit të punëve që e cakton **organi teknik i caktuar për kontrollim**.
8. Afati për kryerjen e riparimeve të rregullta në të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore i cili është dhënë si faktor kufizues, mund të vazhdohet për shkak se mjeti lëvizës hekurudhor ka qenë jashtë operimi nën kushtet e cekura në aneksin 2 dhe 5 të kësaj Rregulloreje.
9. Pas kalimit të afatit të paraparë për kontrollim apo për riparimin e mjetit lëvizës hekurudhor sipas renditjes dhe tejkalimit të lejuar, mjeti lëvizës hekurudhor duhet të largohet nga operimi deri sa të kryet riparimi i paraparë i radhës.

### *Ndarja e punëve të mirëmbajtjes*

#### **Neni 9**

1. Punët e mirëmbajtjes kryhen në:
  - a) Stacionet e udhëtarëve;
  - b) Stacionet e mallrave;
  - c) Punëtoritë e kontrollimeve dhe riparimeve të jashtëzakonshme të vagonëve;

- d) Punëtorinë apo fabrikat për riparimin e rregullt të vagonëve;
  - e) Punëtoritë-depot për servisimin apo kontrollimin e mjeteve tërheqëse;
  - f) Punëtoritë apo fabrikat për mirëmbajtjen e rregullt të mjeteve tërheqëse;
  - g) Punëtoritë për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore për përdorim të posaçëm.
2. Në stacionet e udhëtarëve dhe stacionet e mallrave behet riparimi i jashtëzakonshëm i vagonëve pa shkëputje.
  3. Në punëtorinë për kontrollime dhe riparime të jashtëzakonshme të vagonëve bëhen:
    - a) Kontrollimet;
    - b) Riparimet e jashtëzakonshme të vagonëve të shkëputur nga treni.
  4. Në punëtoritë për mirëmbajtje të rregullt të vagonëve kryhen:
    - a) Kontrollimet;
    - b) Riparimet e rregullta të vagonëve;
    - c) Riparimet e jashtëzakonshme të vagonëve të shkëputur nga treni.
  5. Në punëtoritë-depot për mirëmbajtjen e mjeteve tërheqëse kryhen:
    - a) Servisimet;
    - b) Kontrollimet;
    - c) Riparimet e rregullta (nëse ka kushte për to);
    - d) Riparimet e jashtëzakonshme.
  6. Në punëtoritë apo kompanitë për mirëmbajtjen e rregullt të mjeteve tërheqëse kryhen:
    - a) Riparimet e rregullta;
    - b) Riparimet e jashtëzakonshme;
    - c) Modifikimet dhe rikonstruktivet.

### ***Vëllimi i mirëmbajtjeve të rregullta***

#### **Neni 10**

1. Për çdo lloj të mirëmbajtjes caktohet vëllimi i punëve të domosdoshme me të cilat arrihet siguria e punës dhe operimit të mjetit tërheqës dhe çmobilizimi sillet në vlera minimale.
2. Vëllimi i punëve të caktuara në riparimet e rregullta për çdo seri të mjeteve tërheqëse përmban një pjesë të kushteve teknike të cilin organet kompetente në Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. e përpunojnë në bashkëpunim me punëtorinë e cila i bënë riparimet e rregullta të serive të caktuara të lokomotivave. Më qellim të riparimit sa më kualitativ dhe racional vëllimi i punëve vazhdimisht plotësohet me njohuri të reja nga lëmi i mirëmbajtjes. Të gjitha ndryshimet në vëllimin e punëve i cakton organi kompetent i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A.

3. Gjatë kryerjes së ndonjë lloji të kontrollimit dhe riparimit të rregullt, përveç punëve të detyrueshme të parapara me vëllimin e punëve, sipas nevoje kryhen edhe punë plotësuese. Lejen për kryerjen e këtyre punëve plotësuese e jep organi përgjegjës në Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A.
4. Gjatë kryerjes së ndonjë riparimi të rregullt të mjeteve tërheqëse, riparimi i ndonjë nyje mund të tejkalohet në qoftë se para fillimit të riparimit të mjetit tërheqës në atë nyje është kryer riparimi i jashtëzakonshëm, dhe atë në qoftë se siguron operim dhe punë të sigurt të mjetit tërheqës deri në riparimin e ardhshëm të rregullt.
5. Nëse gjatë kontrollimit të mjetit tërheqës, kontrollimit dhe vërtetimit të pjesëve, nyjave apo pajisjeve vërehet ndonjë parregullsi mjeti tërheqës duhet të silltet në gjendje të rregullt teknike.

### ***Modifikimi dhe rikonstruksionimi i mjeteve lëvizëse hekurudhore***

#### **Neni 11**

1. Gjatë mirëmbajtjes mund të bëhen modifikimet dhe rikonstruksioni i mjetit lëvizës.
2. Me modifikimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore nënkuptohet ndryshimi dhe përmirësimi i elementeve të konstruksionit në mjetin lëvizës hekurudhor, i cili nuk e ndryshon konstruksionin bazë përdorimin teknik dhe eksploatin.
3. Me rikonstruksionim të mjeteve lëvizëse hekurudhore nënkuptohen ndryshimet e konstruksionit në mjetin lëvizës hekurudhor të cilat e ndryshojnë konstruksionin bazë, si dhe përdorimin teknik dhe eksploatin e tyre.

Rikonstruksionet të cilat e ndryshojnë bazën e konstruksionit të mjetit lëvizës hekurudhore i nënshtrohen dispozitave mbi sigurinë e operimit në hekurudhat e Kosovës.

4. Modifikimi dhe rikonstruksioni i mjeteve lëvizëse hekurudhore kryhet në përputhje me rregullat ekzistuese të cilat i sigurojnë Hekurudhave e Kosovës-Trainkos Sh.A. unifikim teknik, në bazë të dokumentacionit teknik të cilin e vërteton organi kompetent në Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A.
5. Modifikimet dhe rikonstruksionimet e mjeteve lëvizëse hekurudhore kryhen gjatë riparimeve të rregullta, por mund të kryhen edhe veçmas në varësi nga nevoja dhe nga mundësia e zvogëlimit të shpenzimeve të përgjithshme me punët e përbashkëta.

## *Dokumentacioni teknik për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse*

### **Neni 12**

1. Në dokumentacionin teknik për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore përfshihet:
  - a) Dokumentacioni i konstruksionit i nevojshëm për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore;
  - b) Kushtet e nevojshme teknike për riparimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore dhe nyjave të tyre;
  - c) Udhëzimet për përdorim të mjetit lëvizës hekurudhor dhe ndonjë pajisje në të;
  - d) Udhëzimet për mirëmbajtjen e mjetit lëvizës hekurudhor, ndonjë nyje, pajisjeve dhe stabilimenteve;
  - e) Përshkrimi i punëve për llojet e mirëmbajtjes së rregullt;
  - f) Katalogu i pjesëve të ndërrimit.
  
2. Dokumentacioni i konstruksionit përbëhet nga vizatimet teknike të nyjave dhe komponentëve si dhe nga shemat e nevojshme për mirëmbajtje.  
Këtë dokumentacion e siguron prodhuesi i mjeteve tërheqëse hekurudhore dhe me të janë të furnizuara punëtoritë të cilat e bëjnë mirëmbajtjen e tyre.
  
3. Kushtet teknike përcaktojnë pikat më të rëndësishme në riparimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore dhe domosdoshmërisht përfshijnë:
  - a) Përshkrimin teknik të mjetit lëvizës hekurudhor;
  - b) Shënimet e eksploatimit dhe të konstruksionit të mjetit lëvizës hekurudhor si dhe të nyjave të tij;
  - c) Klasifikimin e nyjave, pajisjeve dhe stabilimenteve;
  - d) Vëllimin e mirëmbajtjeve të domosdoshme të rregullta të komponentëve;
  - e) Normativin për orët e punës të nevojshme për vëllimin e caktuar të punëve;
  - f) Normativin për sasinë dhe llojin e pjesëve dhe materialet e konsumuara për kryerjen e ndonjë riparimi për çdo mjet lëvizës dhe seri të tyre, normativ i cili punohet në bazë të përvojës dhe gjatë përdorimit i nënshtrohet ndryshimeve dhe plotësimeve periodike;
  - g) Regjistrimi i operacioneve të punës, vërtetimi gjatë riparimit, ku është e obliguar mbikëqyrja nga pronari i mjetit lëvizës hekurudhor dhe kontrolli i kualitetit në punëtori apo në kompaninë e cila e bënë riparimin e mjetit lëvizës hekurudhore;
  - h) Regjistrimi i pajisjeve të nevojshme dhe të domosdoshme për kryerjen e testeve të pjesëve dhe nyjave gjatë riparimit si dhe pajisjeve për testimin përfundimtar të mjetit lëvizës hekurudhor;
  - i) Programi i verifikimit dhe testimit të pajisjes, nyjave dhe pjesëve si dhe vozitjes provuese nëse nevojiten për atë lloj të riparimit;
  - j) Komplet i fletëve matëse të cilat plotësohen gjatë riparimit të pjesëve, nyjave dhe pajisjeve;
  - k) Shikimi i udhëzimeve teknike, standardeve dhe rregullave të nevojshme për kryerjen e riparimit;

- 1) Masat për përgatitjen e punëtorisë me inventar dhe personel të nevojshëm për kryerjen e punëve të caktuara në mirëmbajtjen e serive të caktuara apo nyjave, pajisjeve dhe stabilimenteve të caktuara.
4. Udhëzimet për përdorim caktojnë mënyrën e përdorimit të mjetit lëvizës hekurudhor dhe pajisjeve të montuara në të.
5. Udhëzimet për mirëmbajtje plotësojnë kushtet teknike dhe përcaktojnë veprimet për kryerjen e punëve gjatë riparimit të ndonjë nyje, pajisje apo stabilimenti.
6. Katalogu i pjesëve të ndërrimit në mënyrë pamore tregon të gjitha pjesët përbërëse të mjetit lëvizës hekurudhor të ndara nëpër nyje, skicat në të cilat paraqiten të gjitha pjesët përbërëse, shenjat e katalogut sipas të cilave bëhet porositja e pjesëve, emërtimi i pjesës, shenja e standardit si dhe sasia në një nyje apo në tërë mjetin lëvizës hekurudhor. Katalogu i pjesëve rezervë përgatitet nga prodhuesi i mjetit lëvizës hekurudhor në bashkëpunim me prodhuesin e nyjave dhe në rastin e porositjes së mjetit lëvizës hekurudhor apo nyjave patjetër dërgohet edhe katalogu.

#### *Aftësimi i personelit për punë në mirëmbajtjen e mjetit lëvizës hekurudhor*

#### **Neni 13**

1. Personeli që është i angazhuar në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore, për të kryer punët në nivelin dhe cilësinë e kërkuar, duhet të aftësohet në atë shkallë që të mund:
  - a) Të veprojnë në përputhje me rregullat për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore;
  - b) Të kryejnë punët e caktuara në mirëmbajtje;
  - c) Të përdorin dokumentacionin teknik për mirëmbajtje e veçanërisht dokumentacionin për kryerjen e punëve nga profesioni i tij.
2. Mënyra dhe qasja e aftësimit të personelit që punon në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse përcaktohet me udhëzime të veçanta.

#### *Parakushtet për organizimin e mirëmbajtjes së rregullt*

#### **Neni 14**

1. Që riparimet e rregullta të kryhen në mënyrë të organizuar dhe racionale, që punëtorja të përgatitet me kohë për riparim të shpejt dhe kualitativ duhet:
  - a) Në çdo vit, në muajin qershor, përgatitet plani i riparimeve të rregullta për vitin pasues. Planin përgatitet në bazë të llojit të riparimit dhe serisë së mjeteve lëvizëse dhe shërben si bazë për fillimin e furnizimit me pjesë të ndërrimit;

- b) Në muajin tetor planet grupohen sipas llojit të mjetit lëvizës, sipas llojit të riparimit dhe vendit të riparimit;
- c) Deri në fund të muajit nëntor, për vitin pasues, nga eksperti përgatitet regjistri i pjesëve të ndërrimit për të gjitha llojet e mjeteve lëvizëse.

***Përgatitja dhe dorëzimi i mjetit lëvizës hekurudhor në punëtorinë apo kompaninë për mirëmbajtje të rregullt***

**Neni 15**

1. Çdo mjet lëvizës hekurudhor përgatitet për riparim në bazë të dinamikës të cilën e përcaktojnë së bashku punëtorja apo kompania për riparim dhe organi përgjegjës i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A.
2. Çdo mjet lëvizës hekurudhor, i cili është caktuar për riparim lajmërohet në punëtori apo kompaninë e riparimit veçmas. Në lajmërim duhet të jetë e shënuar gjendja teknike e tij.
3. Gjatë dorëzimit të mjetit lëvizës hekurudhor në punëtori apo kompaninë për riparim formohet procesi mbi pranim dorëzimin e mjetit lëvizës hekurudhor, të cilin e nënshkruajnë përfaqësuesit e punëtorisë apo kompanisë dhe përfaqësuesit e pronarit të mjetit lëvizës hekurudhor. Me këtë rast konstatohet gjendja teknike e mjetit lëvizës si dhe pjesëve të dëmtuara apo pjesëve që mungojnë.  
Gjithashtu, me pëlqimin apo propozimin e pronarit, në formë të shkruar caktohen modifikimet apo rikonstruksionet të cilat do të kryhen krahas riparimit të rregullt.

***Mënyra e kryerjes së riparimit të mjetit lëvizës hekurudhor***

**Neni 16**

1. Mirëmbajtjet e rregullta e mjeteve lëvizëse hekurudhore bëhen në bazë të vëllimit të punëve të parapara për atë lloj të riparimit, sipas kushteve teknike për riparimin e mjetit lëvizës dhe sipas udhëzimit për riparimin e ndonjë nyje, stabilimenti apo pajisje në mjetin e caktuar lëvizës.
2. Riparimi i mjetit lëvizës hekurudhor përbëhet prej riparimit të pjesëve përbërëse, nyjave, pajisjeve dhe stabilimenteve, dhe atë me demontimin e tyre nga mjeti lëvizës kur është fjala për riparimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme dhe pa demontimin e tyre kur është fjala për riparim në kuadër të kontrollimeve. Riparimi, në rend të parë, duhet të kryehet me ndërrimin nyjave të dëmtuara me nyje të riparuar apo të reja.
3. Riparimet në mjetin lëvizës të dëmtuar kryhen sipas nevojë dhe në bazë të dokumentacionit teknik përkatës për mirëmbajtje në pjesën, nyjën, stabilimentin apo

pajisjen që është dëmtuar. Për çdo rast të paraqitur vëllimi i punëve caktohet me proces në punëtorinë apo kompaninë cila e kryen riparimin.

4. Data e riparimeve të rregullta shënohet në tabelën e paraparë për atë riparim në mjetet lëvizëse.
5. Enët dhe gypat nën presion i kontrollon personi profesional të cilin e cakton organi përkatës i HK-Trainkos Sh.A në përputhje me dispozitat ligjore.

### ***Mirëmbajtja e stabilimenteve siguruese të mjetit lëvizës***

#### **Neni 17**

1. Frenat, stabilimentet për kontrollimin e fjetjes, stabilimentet auto-stop, stabilimentet radio dispeçerike, dhe stabilimentet tjera të ngjashme në mjetet lëvizëse mirëmbahen sipas afateve të parapara për ato stabilimente, dhe përshtaten me njërin nga afatet për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse të parapara me këtë Rregullore.
2. Për shkak të rëndësisë së këtyre stabilimenteve, për operim të sigurt, mirëmbajtja e tyre caktohet me kushte të veçanta.

### ***Kontrolli mbi cilësinë e riparimit***

#### **Neni 18**

1. Gjatë kryerjes së riparimeve të rregullta të mjeteve lëvizëse hekurudhore, punët dhe testimet i nënshtrohen mbikëqyrjes. Mbikëqyrja bëhet në bazë të planit të mbikëqyrjes së kualitetit për çdo lloj të riparimit dhe serisë së mjetit lëvizës, veçmas nën përcjelljen e obliguar të pronarit të mjetit lëvizës. Planin e mbikëqyrjes së kualitetit e përgatitë punëtorja apo kompania në bashkëpunim me organin përgjegjës të HK-Trainkos Sh.A. Me këtë plan caktohen punët dhe verifikimet në të cilat duhet patjetër të jenë prezentë pronari i mjetit lëvizës dhe kontrolluesi i kualitetit i punëtorisë apo kompanisë që e bën riparimin.
2. Përgjegjësit e HK-Trainkos Sh.A duhet të caktojnë përfaqësuesin e vet në verifikimin e kualitetit të riparimit për serinë apo llojin e caktuar të mjetit lëvizës.
3. Mënyra e mbikëqyrjes së kualitetit të punëve në punëtori apo kompaninë të cilat i kryejnë riparimet e rregullta në mjetet lëvizëse hekurudhore caktohet me Udhëzimi mbi garancionin e kualitetit të mirëmbajtjes në mjetet lëvizëse hekurudhore.

4. Në kuadër të servisimit dhe kontrollimit të mjetit tërheqës personeli i tërheqjes së trenave duhet të verifikojë kualitetin e punëve të kryera. Në bazë të Rregullores së Tërheqjes së Trenave në HK-Trainkos Sh.A përcaktohen përgjegjësit nga personeli i tërheqjes së trenave si dhe verifikimet që ata i kryejnë.

### ***Balancimi (peshimi) i mjetit lëvizës pas riparimi***

#### **Neni 19**

1. Pas përfundimit të riparimit të rregullt, para vozitjes provuese të nevojshme, nëse është paraparë me vëllimin e punëve për ndonjë lloj të riparimit të rregullt për seri dhe lloj të caktuar të mjetit lëvizës hekurudhor, lokomotiva, treni motorik dhe vagoni i udhëtarëve baraspeshohen për të konstatuar masën e tërë të tyre dhe shpërndarjen e ngarkesës në boshte, gjegjësisht në rrota.
2. Vagoni i mallrave baraspeshohet në peshoret e vagonëve në stacione ku konstatohet masa e tyre (tara). Balancimi duhet të kryhet pas çdo riparimi të rregullt.
3. Mjetet lëvizëse hekurudhore balanohen gjithashtu pas çdo riparimi të jashtëzakonshëm dhe rikonstruksioni si dhe pas ndërrimit të karretave nëse këto punë mund të kenë pasur ndikim në ndryshimin e masës së tërë të tyre apo në shpërndarjen e ngarkesave në to.
4. Balancimi sipas matjeve të parapara në të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore bëhet në bazë të Udhëzimit mbi vozitjen provuese dhe matjen e mjeteve lëvizëse hekurudhore.

### ***Vozitja provuese e mjeteve lëvizëse hekurudhore pas riparimit***

#### **Neni 20**

1. Vozitja provuese e mjeteve lëvizëse hekurudhore behet në bazë të Udhëzimit për vozitjen provuese dhe peshimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore, pas riparimit të rregullt (me përjashtim të vagonëve të mallrave) dhe pas riparimit të jashtëzakonshëm gjatë të cilit janë kryer punë të cilat ndikojnë në sigurinë e komunikacionit.

2. Gjatë kohës së vozitjes provuese dhe pasi që ajo të kryhet, përfaqësuesit e pronarit të mjetit lëvizës dhe kontrolluesi i kualitetit në punëtori apo kompaninë e cila e kryen riparimin bashkarish shikojnë funksionimin e mjetit lëvizës si dhe nivelin e vozitjes.

Mangësitë e vërejtura gjatë vozitjes provuese konstatohen me proces dhe duhet të eliminohen para dorëzimit të mjetit lëvizës në operim.

3. Nëse gjatë vozitjes provuese konstatohet ndonjë parregullsi, e cila ndikon në sigurinë e mjetit lëvizës apo në karakteristikat kryesore të tërheqjes, vozitja provuese përsëritet pas



eliminimit të parregullsive në bazë të Udhëzimi për vozitjen provuese dhe peshimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore. Vetëm pasi të eliminohen të gjitha mangësitë e vërejtura gjatë vozitjes provuese kryhet pranim dorëzimi i mjetit lëvizës të riparuar dhe formulohet procesi për lejimin e tij për operim.

### ***Pranimi i mjetit lëvizës hekurudhor pas riparimi***

#### **Neni 21**

1. Pas kryerjes së riparimit të mjetit lëvizës bëhet pranimi i tij në bazë të një procesi të formuluar të pranim-dorëzimit, të cilin e nënshkruajnë përfaqësuesit e pronarit të mjetit lëvizës dhe kontrolluesi i kualitetit në punëtori apo kompaninë e cila e ka kryer riparimin.
2. Përfaqësuesit e pronarit të mjetit lëvizës, gjatë pranim dorëzimit, i dorëzohen librat e plotësuar dhe të vërtetuara të mjetit lëvizës me përshkrimin e riparimit si dhe listat matëse **dhe atesti i pjesëve, nyjave dhe stabilimenteve të ndërruara.**

### ***Garancioni për kualitetin e riparimit***

#### **Neni 22**

1. Punëtorja apo kompania e cila kryen riparimin duhet të garantojë për kualitetin e punëve të kryera dhe materialit të vendosur.
2. Afatet e garancionit për punët e kryera, pjesët e ndërruara dhe për mjetin lëvizës në tërësi si dhe procedurat për realizimin e garancionit i cakton organi përgjegjës në HK-Trainkos Sh.A.

### ***Mbajtja e shënimeve për mirëmbajtjen e mjetit lëvizës hekurudhor***

#### **Neni 23**

1. Çdo punëtori për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse duhet të organizojë grumbullimin, përpunimin dhe udhëheqjen e shënimeve për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse, të cilat i mirëmban në përputhje me dispozitat e Udhëzimi mbi udhëheqjen e veprimtarisë së tërheqjes së trenave dhe mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse në Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A.
2. Shënimet e kërkuara sipas dispozitave nga pika 1 e këtij neni duhet të përcillen tek autoriteti përgjegjës i HK-Trainkos Sh.A në mënyrën dhe kohën e paraparë në Udhëzimi mbi udhëheqjen e veprimtarisë së tërheqjes së trenave dhe mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse në HK-Trainkos Sh.A.

### III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE


#### Neni 24

1. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje mund të bëhen në çdo kohë në bazë të procedurës së njëjtë dhe nga organi i njëjtë që miraton këtë Rregullore.
2. Në rast të paqartësive, kompetent për interpretimin e kësaj rregulloreje është Bordi i Drejtorëve kurse mendimin profesional për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje e bënë organi përgjegjës në HK-Trainkos Sh.A.
3. Anekset e kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse të saj.
4. Me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe me udhëzimet që kanë dalë në bazë të dispozitave të saja duhet të njoftohen në mënyrë të argumentuar të gjithë të punësuarit që kanë të bëjnë me këtë Rregullore.
5. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Drejtorëve të HK-Trainkos Sh.A. Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon së aplikuari Rregullorja 241 për Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse në Hekurudhat e Kosovës e datës 31.03.2017 nr. 229.



**Jetmir NUKA**

**Kryesues i Bordit të HK-Trainkos Sh.A.**

 TRAINKOS SH.A.  
TRAINKOS D.D.  
TRAINKOS J.S.C.  
Nr.No.Br. I/14  
Dt. 31.01.2024  
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje



# ANEXET

**E RREGULLORES PËR MIRËMBAJTJEN E MJETEVE LËVIZËSE NË  
HK-TRAINKOS SH.A**

**FUSHË KOSOVË  
Janar 2024**

## ANEKS 1

### MIRËMBAJTJA E MJETEVE TËRHEQËSE

1. Mirëmbajtja e mjeteve tërheqëse përmban:
  - a) Mbikëqyrjen e përhershme;
  - b) Larjen dhe pastrimin;
  - c) Servisimet;
  - d) Kontrollimet;
  - e) Riparimet e rregullta.
2. Për çdo muaj shërbimi për tërheqjen e trenave duhet paraprakisht duhet të bëjë planin mujor të kontrollimeve të mjeteve tërheqëse sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
3. Në varësi nga realizimi i planit javor të kontrollimit të mjeteve tërheqëse, shërbimi për tërheqjen e trenave duhet të bëjë përmirësimin e planit për çdo javë tjetër vijuese të atij muaji.
4. Në raste të veçanta nga neni 1 i kësaj pike, në planin e kontrollimeve nuk hynë larja, pastrimi dhe dezinfektimi.

#### *Mbikëqyrja e vazhdueshme*

1. Mbikëqyrjen e vazhdueshme të mjeteve tërheqëse e bëjnë:
  - a) Personeli i tërheqjes së trenave, kur mjete tërheqës është në operim;
  - b) Personeli i tërheqjes kur mjete tërheqës pret për operim jashtë punëtorie;
  - c) Personeli i tërheqjes dhe mirëmbajtjes kur mjete tërheqës është në riparim në punëtorinë amë;
  - d) Personeli i tërheqjes kur mjete tërheqës pret për riparim në punëtori të jashtme.
2. Kur mjete tërheqës (lokomotiva) është në operim, apo pret për operim, mbikëqyrjen e tij e bëjnë personeli i tërheqjes së trenave sipas Rregullores për Tërheqjen e Trenave.
3. Në kuadër të mbikëqyrjes së përhershme shikohet dhe verifikohet gjendja teknike, personeli i tërheqjes nuk është e nevojshme t'i sigurohet qasja në kulm dhe nën mjetin tërheqës.
4. Në rast se gjatë kohës së eksploatimit shfaqet defekt në mjetin tërheqës, personeli i tërheqjes së trenave duhet të veprojnë sipas dispozitave të Rregullores për Tërheqjen e Trenave.
5. Autoriteti përgjegjës në HK-Trainkos Sh.A mund të kërkojë edhe verifikime shtesë të gjendjes për ndonjë seri të mjeteve tërheqëse nëse këtë e kërkojnë kushtet e eksploatimit.

### *Larja dhe pastrimi*

1. Pastërtinë në kabinën e drejtimit të mjetit lëvizës e mban personeli i tërheqjes së trenave në nivelin e paraparë sipas Rregullores për tërheqjen e trenave.
2. Larja dhe pastrimi detal i mjetit lëvizës, nyjave përbërëse, stabilimenteve dhe pajisjeve kryhet gjatë kontrollimeve, riparimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme dhe sipas nevojës edhe gjatë pritjes së mjetit lëvizës në kohën në mes dy trenave. Platforma e jashtme e mjetit lëvizës duhet të pastrohet sipas nevojë e më së voni në kontrollimin tremujor (K3) apo sipas kërkesë së shërbimit të tërheqjes së trenave.
3. Larja, pastrimi dhe dezinfektimi i trenave motorikë kryhet sipas dispozitave të Rregullores mbi Kujdesin e Vagonëve dhe Trenave Motorikë.

### *Servisimi*

1. Servisimet e mjeteve tërheqëse i kryen personeli i punëtorisë-depos pa e tërhequr mjetin tërheqës nga operimi, me mundësi të domosdoshme të shikimit nga kanali si dhe mundësi të qasjes në kulm.
2. Në kuadër të servisimit personeli i mirëmbajtjes i caktuar për servisimin e mjetit tërheqës bënë:
  - a) Kontrollimin dhe verifikimin e punës së rregullt të mjeteve tërheqëse në të gjitha stabilimentet dhe sipas nevojës i plotëson me vajra, lubrifikante, ujë dhe të tjera të nevojshme për punën e tyre;
  - b) Me kujdes të posaçëm bënë verifikimin e gjendjes dhe kontrollimin e pjesës së poshtme të trenit, sistemit të frenimit, stabilimenteve kryesor të sigurisë dhe stabilimenteve tjera mbrojtëse;
  - c) Eliminimin e të gjitha defekteve dhe mangësive të vërejtura gjatë shikimit apo defekteve dhe mangësive të shënuara në librin e pranim dorëzimit të mjetit tërheqës;
  - d) Pastrimin e kabinës nga brenda si dhe dritareve në të;
  - e) Punët tjera të shënuara në përshkrimin e punëve;
  - f) Nënshkrimin e librit me të cilin vërteton se në mjetin tërheqës është kryer servisimi.
3. Personeli i tërheqjes së trenave i caktuar me rregulloren për tërheqjen e trenave në Hekurudhat e Kosovës pas servisimit të mjetit tërheqës me nënshkrimin e tij vërteton se nga personeli i punëtorisë ka marrë mjetin lëvizës në gjendje të rregullt dhe të aftë për operim.
4. Personeli i tërheqjes së trenave nuk e merr mjetin tërheqës pas servisimit nëse gjatë servisimit nuk janë plotësuar kushtet teknike minimale për operimin e mjetit tërheqës të parapara me Rregulloren për tërheqjen e trenave në Hekurudhat e Kosovës.
5. Afati për servisimin e mjeteve tërheqëse mund të shtyhet vetëm atëherë kur mjeti tërheqës dërgohet në punëtorinë për mirëmbajtjen e mjeteve tërheqëse nëse defektet nuk mund të eliminohen në kuadër të servisimit. Pas eliminimit të defekteve dhe para daljes nga punëtoria për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse, personeli i tërheqjes së trenave, sipas rregullores për tërheqjen e trenave duhet të shikojë dhe me nënshkrim të vërtetoj se ka marrë mjetin tërheqës në rregull dhe të aftësuar për operim.

6. Nëse në librin e pranimit dorëzimit është shkruar defekti i ndonjë stabilimenti të mjetit tërheqës pas kthimit nga operimi në shërbimin e tërheqjes se trenave nuk ka servisim, atëherë personeli i tërheqjes së trenave duhet të kërkojë eliminimin e parregullsisë, ndërsa personeli i mirëmbajtjes i caktuar, nëse ka mundësi, duhet ta eliminojë prishjen, në të kundërtën e dërgon mjetin tërheqës në punëtorinë për riparim. Pasi që personeli i punëtorisë e eliminon prishjen në mjetin tërheqës duhet të kryhet servisimi.
7. Servisimi para ripërdorimit të mjeteve tërheqëse kryhet atëherë kur mjeti tërheqës ka pushuar më **tepër se 5 ditë**.
8. Nëse nuk është e nevojshme të kryhet shikimi nën mjetin tërheqës, servisimi i lokomotivave manovruese mund të kryhet edhe pa e sjellë lokomotivën në depo.
9. Koha për kryerjen e servisimit të mjetet lëvizëse dizel matet me kohën në mes të dy servisimeve. Kufizimet kohore në mes të dy servisimeve për mjetet tërheqëse dizel janë dhënë në tabelën 1 të kësaj Rregulloreje. Kjo kohë mund të zgjatet për 15% (që i përgjigjet shmangies së lejuar në ditë) nëse gjendja e mjetit lëvizës e lejon këtë. Për afatet e reja të servisimeve shërbimi i tërheqjes së trenave duhet të njoftojë punëtorinë e cila i mirëmban mjetet tërheqëse.
10. Afatet për servisimin e mjeteve tërheqëse dizel janë dhënë në tabelën 1 të këtij aneksi.

***Tabela 1 Afatet për servisimin e mjeteve lëvizëse dizel***

Tipi	Seria e mjetit tërheqës	Afati i planifikuar (ditë)	Shtimi i lejuar (ditë)
Lokomotivë treni	661, 645, JT 38	3	+1
	G 1700	3	+2
Lokomotivë manovruese	MDD3	3	+2
Trenat motorikë	Y1	1	+1

### ***Kontrollimet***

1. Llojet e kontrollimeve të mjeteve tërheqëse janë:
  - a) Kontrollimet mujore .....K1
  - b) Kontrollimit tremujore.....K3
  - c) Kontrollimit gjashtëmujore..... K6
2. Afati për kryerjen e kontrollimeve mund të shtyhet për kohën e qëndrimit të lokomotivës jashtë operimi nëse koha e tërë e qëndrimit jashtë operimi është më e gjatë se 2 muaj. Në

rast të një vazhdimi të tillë të afatit të kontrollimit para dorëzimit të mjetit tërheqës në operim duhet të kontrollohen stabilimentet e rëndësishme për sigurinë e operimit nëse në atë kohë u është kaluar afati i kontrollimeve sipas Rregullores për mirëmbajtjen e frenave.

3. Kur ndonjë nga punët e përshkruara në kontrollimet K3, K6, nuk mund të kryhen përnjëherë, atëherë ato mund të kryhen në shumë termine duke i shfrytëzuar ndalesat dhe pushimet e mjeteve tërheqëse në turne, por më së shumti për 4 ditë.
4. Masë për kontrollimin ardhshëm është afati i kaluar prej kontrollimit të fundit apo orët e punës së motorit nëse në mjetin tërheqës ekziston numëruesi i orëve të punës së motorit. Ky afat mund të zgjatet për 20% nëse gjendja e mjetit tërheqës është e kënaqshme.
5. Lloji i kontrollimit dhe periudha në mes të dy kontrollimeve për mjetet lëvizëse dizel është dhënë në tabelën 2 të këtij aneksi.

**Tabela 2 Afatet për kontrollimet e mjeteve tërheqëse dizel**

Kontrollimet	Afati		Vërejtje
<b>K1</b>	1 mujor	200 orë pune te dizel motorit *	*vetëm për lok G1700
<b>K3</b>	3 mujor	600 orë pune te dizel motorit *	
<b>K6</b>	6 mujor	1200 orë pune te dizel motorit *	

6. Lloji i kontrollimit si dhe renditja e tyre tek mjetet tërheqëse dizel sipas llojit të tyre është dhënë në tabelën 3 të këtij aneksi.

**Tabela 3 Llojet dhe renditja e kontrollimeve të mjeteve tërheqëse**

Lloji			seria	Lloji dhe renditja e kontrollimeve		
tërheqja	mjeti	shërbimi		K1	K3	K6
Dizel	lokomotiva	Treni	<b>G1700</b>	+	+	+
			<b>661, 645, JT 38</b>	+	+	+
		Manovruese	<b>MDD3</b>	+	+	+
	Treni motorik	Treni (udhëtar)	<b>Vollvo &amp; Fiat</b>	+	+	+

7. Në kuadër të kontrollimeve K6, ndërrohen disa nyje të mjeteve tërheqëse. Nyjat e përdorura duhet të riparohen para afatit të riparimit të mesëm (RM) të mjetit tërheqës në tërësi.

8. Nyjat, sipas rregullit, ndërrohen në gjysmën e afatit të riparimit të mesëm (RM), mirëpo, nëse gjendja teknike e tyre është e mirë, ato mbahen në funksion edhe nëse janë paraparë për ndërtrim. Sipas dispozitave të rregullores për mirëmbajtjen e frenave, për elementet e sistemit të frenimit, shtyrja e afatit të ndërtrimit mund të jetë më së shumti 15 %.
9. Ndërrimi i ndonjë nyje varet nga gjendja teknike e tij, e cila konstatohet me përcjellje gjatë shfrytëzimit dhe verifikimin e gjendjes së saj.
10. Nyjat të cilat ndërrohen para riparimit të mesëm (RM) të mjetit tërheqës si tërësi janë dhënë në tabelën 4 të këtij aneksi.

**Tabela 4 Ndërrimi i nyjave në kontrollime (para RM)**

Seria e mjetit tërheqës	Pajisjet	Vërejtje
<b>661 G1700</b>	Karreta me nyjat e montuara	Te ndërtrimi i rrotave (sipas vlerësimit të organit kompetent të transportit)
	Frenat	Sipas udhëzimit për mirëmbajtjen e frenave
	Kompresori	
	Frenat	Sipas udhëzimit për mirëmbajtjen e frenave
	Ndërrimi i rrotave	Sipas nevojë
	Rrota	Sipas nevojë
	Rrota	Sipas nevojë
<b>MDD3</b>	Dizel motori me pajisje përkatëse	Sipas nevojë
	Ndërruesi	
	Diferenciali	
	Kompresori	
	Frenat	Sipas udhëzimit për mirëmbajtjen e frenave
	Brendia	Sipas nevojë
	Ndërrimi i rrotave	Sipas nevojë

#### ***Riparimet e rregullta***

1. Llojet e riparimeve të rregullta të mjeteve tërheqëse dizel janë:
  - a) Riparimi i mesëm (RM);
  - b) Riparimi kryesor (RK).
2. Me riparim të mesëm (RM) të mjeteve tërheqëse dizel kuptojmë shikimin, kontrollimin dhe riparimin apo ndërtrimin e pjesëve dhe nyjave të caktuara në mjetin tërheqës për ta sjellë atë në gjendje të rregullt teknike për atë lloj të riparimit. Riparimi i mesëm (RM) përfshinë:
  - a) Riparimin apo ndërtrimin e ndonjë pjese, nyje dhe stabilimenti i cili nuk do të mund të funksiononte pa prishje deri në riparimin e ardhshëm të rregullt;
  - b) Verifikimin e punëve të nyjave të caktuara;



- c) Ngjyrosjen e plotë të konstruksionit dhe karretave të mjetit tërheqës.
3. Me riparim kryesor (**RK**) të mjeteve tërheqëse dizel kuptojmë riparimin apo ndërrimin e të gjitha pjesëve dhe nyjave në mjetin tërheqës me qëllim të sjelljes së tij në gjendje të rregullt teknike për atë lloj të riparimit.  
Riparimi kryesor përfshinë:
- a) Riparimin apo ndërrimin e të gjitha pjesëve apo nyjave (mekanike, termike, pneumatike dhe elektrike) në mjetin lëvizës;
  - b) Ngjyrosjen e plotë të konstruksionit dhe karretave të mjetit tërheqës;
  - c) Ndërrimin e instalimit elektrik në mjetin tërheqës;
  - d) Realizimin e modifikimit në mjetin tërheqës.
4. Masë për renditjen e kontrollimeve të mjeteve tërheqëse dizel është sasia e karburantit të shpenzuar prej riparimit të rregullt të fundit apo numri i orëve të punës së motorit nëse në mjetin tërheqës është i montuar matësi i orëve të punës së motorit, koha e kontrollimit mund të vazhdohet për 20% nëse gjendja e mjetit tërheqës lejon këtë.
5. Vazhdimi i afatit të riparimeve në bazë të kilometrave të kaluara apo në bazë të karburantit të shpenzuar është dhënë në aneksin 2 të kësaj rregulloreje.
6. Afati kohor ndërmjet dy riparimeve të rregullta radhazi të mjetit tërheqës është 12 vjet, me faktin se, nëse gjendja e mjetit është e kënaqshme, afati kohor ndërmjet dy riparimeve të rregullta radhazi mund të zgjatet dy herë me një vit. Procedura e vazhimit të afatit të riparimit për çdo vit është dhënë në aneksin 2 të kësaj Rregulloreje.
7. Pronari i mjetit tërheqës në bashkëpunim me Mirëmbajtjen e Mjeteve Tërheqëse përcaktojnë si masë faktorin KM e kaluara, karburantin e shpenzuar apo faktorin kohë për riparimet e rregullta të mjetit tërheqës.
8. Afati kohor i shfrytëzimit të mjetit lëvizës fillon të llogaritet nga momenti i futjes në operim të mjetit lëvizës.
9. Nëse asnjëra nga masat (afati kohor apo karburanti i shpenzuar) në mes të dy riparimeve të rregullta nuk është plotësuar, atëherë afati kilometër në asnjë mënyrë nuk mund të tejkalohet, që do të thotë se mjeti tërheqës duhet të shkojë në riparimin adekuat sipas radhës sepse kilometrat e kaluara në gjendjen teknike të mjetit tërheqës në pikëpamje të sigurisë teknike apo të sigurisë së operimit kanë ndikim të rëndësishëm.
10. Masa normative në mes të dy riparimeve të rregullta deri te riparimi i mesëm (RM) apo riparimi kryesor (RK) për lokomotiva dhe trena motorikë është dhënë në tabelën 5 të këtij aneksi për çdo seri të mjeteve tërheqëse. Duhet pasur kujdes për llojin e mjetit të tërheqjes, llojin e shërbimit (udhëtarëve, mallrave apo manovruese) dhe shënimeve tekniko-eksplotuese (fuqia, shpejtësia maksimale, zgjedhjet e konstruksionit të mjetit tërheqës dhe të ngjashme).
11. Vëllimi i punëve në riparimet e rregullta caktohen veçmas për çdo lloj dhe seri, ashtu që vëllimi i punëve të disa serive mund të paraqiten dallime të caktuara për riparime në rangun e riparimit të mesëm (RM), varësisht nga vjetërsia e mjetit tërheqës apo nga puna e tërë e shprehur në kilometrat e kaluara nga fillimi i eksplotimit të mjetit tërheqës.

12. Afati për shikimin e rezervarit nën presion në mes të dy riparimeve të rregullta për të gjitha mjetet tërheqës është i definuar në Rregulloren për mirëmbajtjen e frenave.
13. Riparimi i rregullt i karretave dhe pjesëve tjera të mjeteve tërheqëse mund të kryhet ndaras nga riparimi i rregullt i mjeteve tërheqëse në tërësi, ashtu që për ato nyje të udhëhiqet dokumentacioni i posaçëm.
14. Riparimi i karretave apo nyjave të karretës kryhet gjatë ndërrimit të rrotave apo unazave (bandazheve) çka nuk mund të jetë e përshtatur me ciklin e riparimeve të rregullta të mjetit tërheqës në tërësi. Vendimin për atë se a kryhet riparimi i rregullt i karretës apo vetëm nyjave të posaçme të saj, gjatë ndërrimit të rrotave apo unazave (bandazheve), e merr komisioni i përbashkët përgjegjës në HK-Trainkos SH.A.

**Tabela 5 Masat normative për riparimin e rregullt të mjeteve tërheqëse dizel**

Lloji			Seria e mjetit lëvizës	Afati në mes dy riparimeve të rregullta		Vërejtje
Tërheqja	Mjeti lëvizës	Shërbimi		Shpenzimi i karburantit (t)	Kilometrat e kaluara	
Dizel	Lokomotiva	Treni	<b>G1700*</b>		800.000	)* 36000 orë pune të dizel motorit )** Shpenzimet për motor
			<b>661, 645</b>	6 400	1.000 000	
		Manovruese	<b>MDD3**</b>	320		
					–	
	Trena motorikë	Treni (udhëtarëve)	<b>Vollvo</b>	–	900 000	
			<b>Fiat</b>	–	450 000	

## **ANEKS 2**

### **PROCEDURAT PËR KRYERJEN E SHIKIMIT PËR ZGJATJEN E AFATIT PËR RIPARIMIN E RREGULLT TË MJETIT TËRHEQËS**

1. Procedura për vazhdimin e afatit të riparimit të rregullt të mjetit tërheqës kryhet pas kalimit të afatit për riparim të rregullt.
2. Për zhvillimin e procedurave për vazhdim të afatit të riparimit të rregullt të mjeteve tërheqëse HK-Trainkos Sh.A krijon komision të veçantë, në të cilin përfshihen dy përfaqësues të depon dhe një përfaqësues i tërheqjes së trenave të cilës i përket mjeteve të lëvizës. Përbërja e këtij komisioni përgjegjës të HK-Trainkos Sh.A caktohet një herë në vit me propozimin e shërbimit të tërheqjes së trenave.
3. Shikimi për vazhdimin e afatit për riparimin e rregullt të mjetit tërheqës bëhet në depon amë në vëllimin e punëve të kontrollimit K6.
4. Nëse nga kontrollimi i fundit K6 kanë kaluar më pak se tre muaj atëherë mund të bëhet shikimi për vazhdimin e afatit për riparim të rregullt të mjetit tërheqës në vëllimin e punëve që i përgjigjet kontrollimit K3.
5. Pas shikimit komisioni përgatitë raportin, i cili patjetër përmban vlerësimin se sa mjete tërheqës i plotëson kushtet për operim deri në riparimin e rregullt të ardhshëm

## ANEKS 3

### MIRËMBAJTJA E VAGONËVE TË UDHËTARËVE

#### a) MIRËMBAJTJA E RREGULLT E VAGONËVE TË UDHËTARËVE

1. Mirëmbajtja e rregullt e vagonëve të udhëtarëve përfshinë:
  - a) Mbikëqyrjen e përhershme;
  - b) Larjen, pastrimin dhe dezodorantizimin;
  - c) Dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin;
  - d) Kontrollimet;
  - e) Riparimet e rregullta.

#### *Mbikëqyrjen e vazhdueshme*

1. Mbikëqyrja e vazhdueshme në vagonët e udhëtarëve kryhet:
  - a) Gjatë përgatitjes për operim;
  - b) Gjatë operimit në komunikacion;
  - c) Pas operimit.
2. Gjatë përgatitjes së vagonit për operim, në stacionet prej nga ku vagoni nis, kontrolli kryhet nga kontrolluesi i vagonëve.
3. Gjatë operimit (në komunikacion) të vagonit të udhëtarëve personeli i trenit vazhdimisht e mbikëqyrë gjendjen e tij. Të gjitha mangësitë e vërejtura personeli në tren i shënon në formularin e caktuar, ashtu që ato, varësisht nga lloji, duhet të evitohen në stacionin e fundit, në stacionin amë apo në punëtorinë e vagonëve
4. Pas përfundimit të përdorimit të vagonit të udhëtarëve, kontrolli kryhet nga kontrolluesi i vagonëve.

#### *Larja, pastrimi dhe dezodorantizimi*

1. Larja dhe pastrimi i vagonëve të udhëtarëve bëhet sipas Rregullores për kujdesin e vagonëve hekurudhor dhe trenave motorikë.
2. Dezodorantizimi bëhet sipas nevojës pasi që të kryhet larja dhe pastrimi apo para vendosjes në tren.

#### *Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi*

1. Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi bëhet në përputhje me Rregulloren për kujdesin e vagonëve hekurudhor dhe trenave motorikë.

### ***Kontrollimet***

1. Llojet e kontrollimeve në vagonët e udhëtarëve janë:
  - a) Kontrollimet mujore.....K1
  - b) Kontrollimet dy mujore.....K2
  - c) Kontrollimet tremujore.....K3
2. Kontrollimet njëmujore, dymujore dhe tremujore kryhen në stacionet punuese apo punëtori.
3. Vëllimi i punëve në vagonët e udhëtarëve të kontrollimet është i caktuar në Udhëzimin për kontrollime dhe riparimet e rregullta në mjetet lëvizëse hekurudhore.
4. **Kontrollimet në vagonët e jashtëm të huazuar nga HK-Trainkos Sh.A apo të kontraktuar për kontrollime në HK-Trainkos Sh.A i nënshtrohen rregullave të Rregullores RIC.**
5. Vëllimi i punëve në kontrollimin një mujor (K1) është i njëjtë me vëllimin e punëve të kontrollimit dy mujor (K2).

***Tabela 1 Renditja dhe afatet e kontrollimeve***

Lloji i vagonit	Lloji i kontrollimeve	
	K1	K2
	ditë	
4-boshtor (deri 120 km/h)		60+10
4-boshtor (mbi 120 km/h)	30+10	

6. Afati i kontrollimeve K2, te vagonët 4 boshtorë, me shpejtësi deri në 120 km/h, varësisht nga gjendja, mund të zëvendësohen me kontrollim K1. Propozimin për kalimin nga K2 në K1 e bënë punëtori e cila i kryen kontrollimet.

### ***Riparimi i rregullt***

1. Llojet e riparimeve të rregullta në vagonët e udhëtarëve janë:
  - a) Riparimi i mesëm;
  - b) Riparimi kryesor.
2. Me riparim të mesëm (RM) në vagonët e udhëtarëve nënkuptojmë shikimin dhe riparimin apo edhe nderimin e pjesëve, nyjave dhe stabilimenteve në vagonë për sjelljen e tyre në gjendje të rregullt teknike, por sipas vëllimit të punëve të paraparë për atë lloj të riparimit. Punët kryhen në bazë të udhëzimit për kontrollimin dhe riparimin e rregullt të mjeteve lëvizëse hekurudhore.

3. Me riparim kryesor (RK) të vagonëve të udhëtarëve nënkuptohet zëvendësimi detal i të gjitha pjesëve dhe nyjave të konsumuara dhe të dëmtuara në vagonë me qëllim të sjelljes së vagonit në gjendje të rregullt teknike sipas vëllimit të punëve të parapara për atë lloj të riparimit. Në këtë riparim, nga vagoni patjetër duhet të largohen të gjitha pjesët, **nyjat dhe stabilimentet dhe të zëvendësohen me të reja**. Duhet të ndërrohen bartësit e karretave dhe skeleti i vagonit nëse kanë korrozion të madh, ndërsa konstruksioni i vagonit duhet të pastrohet deri në metal dhe tërësisht të mbrohet me ngjyrë.
  - 3.1. Në këtë lloj të riparimit punët kryhen sipas përshkrimit të veçantë të punëve, të cilin në bazë të gjendjes së vagonit e bënë organi përgjegjës në HK-Trainkos Sh.A.
  - 3.2. Te ky lloj i riparimit sipas nevojë mund të bëhen edhe rikonstruksione të vagonit, të cilin e propozon dhe verifikon komisioni kompetent në HK-Trainkos Sh.A.
4. Para ndarja e vagonëve të udhëtarëve, duke pas parasysh regjimin e përdorimit në pikëpamje të shpejtësisë maksimale dhe të ngjashme, mund të kryhet në njërin nga riparimet e rregullta ashtu që për këto punë vendimi merret nga organi kompetent në HK-Trainkos Sh.A, i cili duhet të caktojë numrin e ri të vagonit.
5. Disa stabilimente të veçanta në vagonë mirëmbahen sipas udhëzimeve të posaçme, për të cilat duhet pasur kujdes që punët në ato stabilimente të përfshihen në ciklin dhe afatin e kontrollimeve dhe riparimit të rregullt të vagonëve të udhëtarëve.

### ***Renditja dhe afati i riparimeve të rregullta***

1. Renditja dhe afati i riparimeve të rregullta në vagonët e udhëtarëve varet nga operimi i vagonëve i shprehur në km dhe nga koha e shfrytëzimit të tyre. I vlefshëm është ai kusht i cili plotësohet i pari.  
Afati kohor i shfrytëzimit të mjetit lëvizës fillon të llogaritet nga momenti i futjes në operim të mjetit lëvizës.
2. Afati kohor në mes dy riparimeve është gjashtë (6) vite dhe mund të vazhdohet nga gjashtë muaj pandërprerë deri në arritjen e kilometrave maksimale të lejuara në këtë rregullore nëse këtë e lejojnë kushtet teknike të vagonit. Për vazhdimin e afatit kohor të riparimit të vagonit vendos organi i caktuar nga Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A.
3. Afati i rregullt i riparimit të ardhshëm bazuar në kriterin kohë duhet të shënohet në kornizën e vagonit, ndërsa afati kohor i vazhduar i riparimit të rregullt shënohet po ashtu në kornizën e vagonit, por me shenjen “+”.
4. Veprimi për vazhdimin e afatit dhe volumi i punëve të cilat duhet të kryhen për vazhdimin e afatit për riparim të rregullt të vagonëve është dhënë në aneksin 5 të kësaj Rregulloreje.

***Tabela 2 Renditja dhe afati i riparimit të rregullt të vagonëve të udhëtarëve***

Lloji i vagonit	Renditja dhe afati i riparimeve të rregullta				
	RM	RM	RM	RM	RK

	Masa për riparim (koha e eksplotimit: vitet apo kilometrat e kaluara)				
Vagon me shpejtësi deri 100 km/h	6 vite apo 200 000 km	6 vet apo 200 000 km	5 vite apo 200 000 km	6 vjet apo 200 000 km	RM-RM-RM-RM-RK
Vagon me shpejtësi deri 120 km/h	6 vjet apo 750 000 km	6 vjet apo 750 000 km	6 vjet apo 750 000 km	6 vjet apo 750 000 km	RM-RM-RM-RM-RK
Vagon me shpejtësi 100 deri 160 km/h	6 vjet apo 800 000 km	6 vjet apo 800 000 km	6 vjet apo 800 000 km	6 vjet apo 800 000 km	RM-RM-RM-RM-RK
Vagon me shpejtësi deri 200 km/h	6 vjet apo 1 000 000 km	6 vjet apo 1 000 000 km	6 vjet apo 1 000 000 km	6 vjet apo 1 000 000 km	RM-RM-RM-RM-RK

6. Në qoftë se gjatë mirëmbajtjes së vagonëve është kryer rikonstruktimi apo modifikimi i pjesëve të vagonit të lidhura me sigurimin e operimit, afati i kryerjes së riparimit kryesor (RK) mund të vazhdohet tutje, për çka vendosin organet përgjegjëse në sektorin e transportit dhe të mirëmbajtjes së vagonëve. Procedura për vazhdimin e riparimit dhe volumi i punëve është përcaktuar në aneksin 5 të kësaj Rregulloreje.

#### **b) RIPARIMI I JASHTËZAKONSHËM I VAGONËVE TË UDHËTARËVE**

- Riparimi i jashtëzakonshëm i vagonëve të udhëtarëve kryhet sipas nevoje dhe ndahet në:
  - Riparime pa shkëputje nga treni;
  - Riparime me shkëputje nga treni.
- Riparimi i jashtëzakonshëm i vagonëve të udhëtarëve ku hynë dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi kryhet sipas nevoje.
- Me rastin e eliminimit të parregullsive për të cilat vagoni është dërguar në punëtori është e obligueshme edhe kontrollimi dhe sipas nevoje edhe riparimi i pjesëve, nyjave dhe stabilimenteve tjera nëse është vërejtur parregullsi apo dëmtim i tyre

## ANEKS 4

### MIRËMBAJTJA E VAGONËVE TË MALLRAVE

#### a) RIPARIMI I RREGULLT I VAGONËVE TË MALLRAVE

1. Riparimi i rregullt i vagonëve të mallrave është riparim i cili planifikohet paraprakisht dhe përsëritet në mënyrë periodike.
2. Riparimi i rregullt i vagonëve të mallrave ndahet në:
  - a) Kontrollime;
  - b) Riparime të rregullta.

#### *Kontrollimet*

1. Te vagonët e mallrave kryhet vetëm një lloj i kontrollimit.
2. Kontrollimi i vagonëve të mallrave përfshinë kontrollimin e të gjitha pjesëve përbërëse dhe nyjave sipas udhëzimit për kontrollimin teknik dhe riparimin e rregullt të mjeteve lëvizëse hekurudhore si dhe përpunimin dhe lubrifikimin e të gjitha stabilimenteve duke përfshi edhe frenat dhe kushinetat e boshteve.
3. Kontrollimet e vagonëve të mallrave kryhen dhe trajtohen në mënyrë të njëjtë si riparimet e jashtëzakonshme me shkëputje nga treni.
4. Kontrollimet në vagonët e mallrave kryhen në kohën e cila është e shënuar në vagonë me zgjatje të afatit për  $\pm 3$  muaj. Nëse në këtë kohë kryhet riparimi i jashtëzakonshëm i vagonit të mallrave me shkëputje nga treni, atëherë patjetër duhet përsëritet kontrollimi i vagonit.
5. Kontrollimi i vagonëve të mallrave kryhet aty ku ka kushte për kontrollim apo në punëtorinë e autorizuar për kontrollimin e vagonëve të serive të caktuara. Punëtorja duhet të jetë e autorizuar për kryerjen e kontrollimeve në vagonët e mallrave nga organi përgjegjës në Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A.

#### *Riparimi i rregullt*

1. Llojet e riparimeve të rregullta të vagonëve të mallrave janë:
  - a) Riparimi i mesëm (RM);
  - b) Riparimi kryesor.
2. Me riparim të mesëm (RM) të vagonëve të mallrave nënkuptohet shikimi dhe riparimi i ndonjë pjese apo nyje në vagonë me qëllim të sjelljes së tij në gjendje të rregullt teknike. Riparimi i mesëm (RM) përfshinë:
  - a) Shikimin dhe riparimin të gjitha nyjave dhe stabilimenteve siguroese (pjesën e poshtme, frenave, pajisjeve lidhëse dhe parapritëse) dhe mekanizmit në vagonë;
  - b) Riparimi dhe matja e karretave dhe trupit të vagonit;



c) Ngjyrosja e vagonit.

3. Me riparim kryesor (RK) të vagonëve të mallrave kuptojmë ripërtëritjen dhe riparimin detal të të gjitha pjesëve apo nyjave të konsumuara dhe të dëmtuara të vagonit me qëllim të sjelljes së tij në gjendje teknike të rregullt. Në këtë lloj të riparimit nga vagoni patjetër duhet të largohen të gjitha pjesët, nyjat dhe stabilimentet, duhet të ndërrohen të gjithë bartësit e karretës dhe skeleti me korrozion të lartë, kurse konstruksioni i vagonit duhet të pastrohet deri në metal dhe të ngjyroset me ngjyrë mbrojtëse tërësisht.
  - 3.1. Te ky lloj i riparimit punët kryhen sipas përshkrimit të veçantë të punëve që varësisht nga gjendja e vagonit, seria, tipi dhe varësisht nga volumi i punëve në frena si dhe sipas dispozitave të Udhëzimit për mirëmbajtjen e frenave në mjetet lëvizëse hekurudhore, të cilin e cakton organi kompetent i HK-Trainkos Sh.A dhe punëtorja për riparimin e vagonëve.

### ***Renditja dhe afatet për riparimin e rregullt***

1. Renditja dhe afatet për mirëmbajtjen e rregullt të vagonëve të mallrave janë caktuar varësisht nga lloji i kushinetave në boshte, shpejtësia maksimale e lejuar e lëvizjes si dhe për qëllimin e përdorimit të vagonit, konstruksionit dhe vjetërsisë së vagonit, ndërsa afatet e riparimit dhe renditja sipas serive janë dhënë në tabelën 1 të këtij aneksi.
2. Masë për caktimin afateve të kontrollimeve dhe riparimeve të rregullta është afati kohor.
3. Zgjatja e lejuar e afatit kohor të riparimeve të rregullta të vagonët e mallrave për transport ndërkombëtar (vagonët me shenjen RIV) duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Rregullores RIV.
4. Afatet e parapara për riparimin e rregullt të vagonët e mallrave në operimin e brendshëm mund të vazhdojnë dy herë pa ndërpre nga gjashtë muaj nëse këtë e lejon gjendja e tyre teknike për çka vendos organi kompetent i HK-Trainkos Sh.A. Procedura e vazhdimin të afatit dhe volumit të punëve, të cilat duhet të kryhen për vazhdimin e afatit të riparimit janë paraparë në aneksin 5 të kësaj Rregulloreje.

**Tabela 1 Afatet për riparimin e rregullt dhe kontrollimin e vagonëve të mallrave (në vite)**

Lloji dhe shpejtësia e vagonit	Seria e vagonit		Afatet e riparimit të rregullt		Afatet e kontrollimit
	shkronja	numerike	Për RM	Për RK	
2-boshtorë 100 km/h	Gbs-z	150	6	18-24	-
	Hbis-z	224	6	18-24	3
	Hbills-z	227	6	18-24	3
	Hrrs-z	290	6	18-24	-
	Kgs-z	332	6	18-24	-
	U-tz	940	5	Pa RK	2,5
2-boshtorë 120 km/h	Lgnss-z	443	6	18-24	-
4-boshtorë 120 km/h	Tadnss-z	093	5	18-22	1
	Habbinss-z	287	6	18-24	3
	Sgnss-z	457	6	18-24	*) <sup>7</sup>
4-boshtorë 100 km/h	Gas-z	190	6	18-24	-
	Rils-z	354	6	18-24	3
	Rs-z	390	5	18-22	-
	Rgs-z	391	6	18-24	-
	Smmps-tz	472	5	18-22	-
	Uais-z	992	5	18-22	2,5
	Tads-z	082	5	18-22	1
	Eas-z	595	5	18-22	-
	Fals-z	665	5	18-22	1
	Faccs-z	699	5	18-22	2,5
	Uas-z	930	5	18-22	1*) <sup>3</sup>
	Eamos-z	594	5	18-22	1
	Uacs-z	932	5	18-22	1
	Uacns-z	932	5	18-22	1
	Zas-z	785	6	18-24	3
	Zaes-z	788	6	18-24	3
	Zakks-z	790	5	18-22	2,5
	Zaekks-z	794	5	18-22	2,5
	Zas-z	796	6	18-24	3
	Zaes-z	798	6	18-24	3
Zaes-z	799	6	18-24	3	
Zagkks-z	791 (plin)	6	18-24	3	
10-boshtorë 100 km/h	Uaais-z	995	5	18-24	2,5
2-boshtorë 80 km/h	Z-vz	706	5	Pa RK	2,5*) <sup>4</sup>
	Ze-vz	708	5	Pa RK	2,5*) <sup>4</sup>
	Uckk-z	900	5	Pa RK	1
	Ukv-zž	905, 908, 909, 910	5	Pa RK	-

	U-tz	950	3	-	1,5
--	------	-----	---	---	-----

Lloji dhe shpejtësia e vagonit	Seria e vagonit		Afati i riparimit të rregullt		Afati i kontrollimit periodik
	shkronja	numra	Për RM	Për RK	
Vagon 4-boshtorë 80 km/h	Uadkk-zž	920	5	18-22	*) <sup>1</sup>
	Uakk-zž	921	5	18-22	2,5*) <sup>1</sup>
	Uaddkk-zž	924	5		2,5*) <sup>1</sup>
	Uaikk-zž	991	5	18-22	2,5*) <sup>1</sup>
Vagon 8-boshtorë 100 km/h	Saadkms-z	498	4*) <sup>7</sup>	18-22	1*) <sup>8</sup>
Vagon 8-boshtorë 80 km/h	Uaai-z	994	4	18-22	2
Vagonë për shpejtësi deri 60 km/h	Uk-zž	905	3, Kushineta rrëshqiste	Pa RK	*) <sup>5</sup>
	Uk-zž	905	5, kushineta rrotulluese	Pa RK	*) <sup>5</sup>
	Uk-zž	905	3, Kushineta rrëshqiste	Pa RK	*) <sup>6</sup>
	Uakk-zž	906	5	Pa RK	2,5
	Ukk-ž	907	5	Pa RK	2,5
	Uas-zž	930	5, Kushineta	Pa RK	*) <sup>6</sup>
	Uak-zž	925	5	Pa RK	*) <sup>6</sup>
Vërejtje:	<p>*)<sup>1</sup> – Te të gjithë vagonët e mallrave të prodhuar para vitit 1980 nuk parashihet RK</p> <p>*)<sup>2</sup> Te të gjithë vagonët e mallrave të prodhuar nga viti 1980 dhe më vonë duhet të kryhet RK</p> <p>*)<sup>3</sup> – Vagonët e serisë Uas-z me dy kompresorë</p> <p>*)<sup>4</sup> – Kushinetat rrëshqiste, 3 vite</p> <p>*)<sup>5</sup> – Shkojnë me vagonin e trenit ndihmës (uji, nafta, për ngrohje)</p> <p>- Kushinetat rrëshqiste, 3 vite</p> <p>- Kushinetat rrotulluese, 5 vite</p> <p>*)<sup>6</sup> – Vagoni i trenit ndihmës</p> <p>*)<sup>7</sup> – Nëse vagoni i kalon 160.000 km para kalimit të kohës prej 4 vitesh, dërgohet në RM para afatit të paraparë</p> <p>*)<sup>8</sup> – Nëse vagoni i kalon 25.000 km para kalimit të kohës prej 1 viti dërgohet në kontrollim para afatit të paraparë.</p>				

## **b) RIPARIMI I JASHTËZAKONSHËM I VAGONËVE TË MALLRAVE**

1. Riparimi i jashtëzakonshëm i vagonëve të mallrave kryhet sipas nevoje dhe ndahet në:
  - a) Riparim pa shkëputje nga treni kur në stacion apo në stacionin zyrtar riparimi i vagonit kryhet në kompozicionin e trenit;
  - b) Riparim me shkëputje nga treni kur vagoni largohet nga operimi dhe dërgohet në punëtori për riparim.
2. Riparimin e jashtëzakonshëm pa shkëputje nga treni e kryen punëtori i kualifikuar, sipas nevoje edhe kontrolluesi i vagonëve. Duhet të synohet që sa më shumë riparime të jashtëzakonshme në vagonë të kryhen pa shkëputje nga treni.
3. Riparimi i jashtëzakonshëm me shkëputje kryhet në punëtoritë për riparimin e vagonëve dhe këto riparime ndahen në:
  - a) Riparime të jashtëzakonshme me shkëputje nga treni për shkak të dëmtimeve të shkaktuara gjatë operimit të vagonit
  - b) Riparime të jashtëzakonshme të vagonit në bazë të obligimeve të garancionit, të cilat në bazë të Udhëzimit për garancion, kryhen në ngarkesë të punëtorisë e cila e ka kryer riparimin e fundit të vagonit. Vëllimi i punëve me këtë rast përcaktohet me proces në mes të punëtorisë e cila e jep garancionin dhe punëtorisë e cila duhet të kryejë riparimin. Vëllimi i punëve, përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar dhe lartësinë e shpenzimeve të riparimit e konstaton komisioni.
4. Me rastin e eliminimit të parregullsisë, për të cilat vagoni është dërguar në punëtori, është e obligueshme shikimi dhe sipas nevoje riparimi i pjesëve, nyjave apo stabilimenteve tjera nëse konstatohet se janë të prishura apo të dëmtuara.
5. Në riparimin e jashtëzakonshëm të vagonëve të mallrave përfshihen larja, pastrimi, dezinfektimi dezinfektimi dhe deratizimi i vagonit të cilat kryhen sipas nevoje dhe sipas dispozitave të Rregullores për kujdesin e vagonëve hekurudhorë dhe trenave motorikë.

## ANEKS 5

### PROCEDURA PËR KRYERJEN E KONTROLLIMIT PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË RIPARIMIT TË RREGULLT TË VAGONËVE

1. Procedura për vazhdimin e afatit të riparimit të rregullt të vagonëve fillon pasi të kalojë afati i riparimit të rregullt.
2. Këtë procedurë e inicion komisioni kompetent i HK-Trainkos Sh.A, i formuar për këtë çështje.
3. Procedura përfshinë:
  - a) Kërkesën për vazhdimin e afatit të riparimit të rregullt;
  - b) Shikimin e vagonit nga komisioni;
  - c) Procesin e shikimit të komisionit.
4. Gjatë shikimit të vagonit nga komisioni patjetër duhet të bëhet:
  - a) Shikimi detal me matjen i nyjave boshtore (trashësia e kurorës-*Tk*, lartësia e kurorës *Lk*, distanca e kurorës- *Dk* dhe pjerrtësia e kurorës- *Qr*);
  - b) Shikimi detal i lakueshmërisë së sistemit;
  - c) Shikimi i pirunëve të boshteve me kontrollimin e zhvendosjeve gjatësore dhe tërthore;
  - d) Shikimi i pajisjeve lidhëse dhe parapritëse;
  - e) Prova e frenave (kontrolli i përforcimeve dhe funksionalitetit) sipas dispozitave të Udhëzimit për mirëmbajtjen e frenave;
  - f) Kontrolli i pajisjeve tjera në vagonët e udhëtarëve (ndriçimi, ngrohja, pneumatika e dyerve, instalimi i ujit);
  - g) Kontrolli i pajisjeve të posaçme në vagonët e mallrave (pneumatika, mekanizmit për hapjen e kulmit, kthinave për zbrazje, armaturave të cisternave)
  - h) Lubrifikim i nyjave dhe sipërfaqeve fërkuese;
5. Te vagonët 4 boshtorë shikimi për vazhdimin e afatit të riparimit të rregullt kryhet në kanal.

## ANEKS 6


### VEPRIMI ME MJETIN MOTORIK PAS RASTIT TË JASHTËZAKONSHËM

1. Me ngjarje të jashtëzakonshme në dispozitat e kësaj Rregulloreje nënkuptojmë:
  - a) Fatkeqësitë;
  - b) Aksidentet;
  - c) Ngjarjet e jashtëzakonshme në vend-kalimet hekurudhore dhe gjetkë;
  - d) Defektet teknike në stabilimente.
2. Pas rastit të jashtëzakonshëm duhet të bëhet kontrollimi vizual në vend ndodhjen e aksidentit për konstatimin e mundësive të transportit deri në punëtorinë ku do të bëhet kontrollimi detal i tij. Me këtë rast caktohet shpejtësia e lëvizjes së tërheqjes së mjetit, i cili ka pësuar aksident. Nëse konstatohet së mjeti nuk mund të operojë ai nën kushte të veçanta tërhiqet si tërësi apo pjese pjesë dhe dërgohet në punëtorinë për riparim.
3. Te kontrollimi detal pas rastit të jashtëzakonshëm të mjetit, në punëtorinë përkatëse duhet të kontrollohen nyjat dhe pjesët për të cilat parashihet se mund të jenë dëmtuar në aspektin e gjeometrisë së tyre dhe në aspektin material (plasaritjet, thyerjet etj.). Me këtë rast duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë:
  - a) Karretave;
  - b) Nyjave boshtore;
  - c) Shtratit të mjetit;
  - d) Sistemit të frenimit;
  - e) Në lidhjet e nyjave dhe pajisjeve në vendet e tyre (kontrollohen zhvendosjet e mundshme të tyre);
  - f) Te mjetet dizel duhet të vërtetohen lidhjet koaksiale të nyjave kryesore.
4. Varësisht nga dëmi i shkaktuar në rastin e jashtëzakonshëm, vozitja provuese duhet të bëhet në bazë të Udhëzimit për vozitjen provuese dhe peshimin e mjeteve lëvizëse hekurudhore.

**Jetmir NUKA**

**Kryesues i Bordit të HK-Trainkos Sh.A.**






# trainkos

## Hekurudhat e Kosovës

91a

		<b>Datë: 30.01.2024</b>
<b>Për:</b>	U.d K.E z.Agron Statovci	
<b>Nga:</b>	Arbër Salihu, U.d Udhëheqës i Zyrës Ligjore	
<b>TEMA:</b>	Komente shtesë nga ZL sipas kërkesës nga Bordi i Drejtorëve për Draft-rregulloresn 241 për MML	



Të nderuar,

Marrë për bazë kërkesën tuaj, gjithashtu, i njoftuar me atë që lënda për punën me rregulloren në fjalë është trajtuar dhe ka marrë edhe opinionet e tjera. Referuar raportit të Komisionit për rishikim të saj, i cili ka nxjerrë propozimet konkrete, nga ku i njëjti ka rekomanduar të bëhen ndryshime dhe plotësime, si nw rregullore ashtu edhe në në Aneksat saj. Marrë parasysh thirrjen ligjore dhe dokumentet tjera përcjellëse, kompetencat ekskluzive të Bordit të Drejtorëve në miratimin e rregulloreve dhe politikave strategjike, referuar kërkesës për opinionin e mëparshëm nga Zyra Ligjore lidhur me versionin për Rregulloren për Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse Hekurudhore; rregulloja tashmë ka kaluar stadet e punës duke marrë nivelet e sigurisë dhe aprovimeve të të gjithë komisioneve dhe palëve të tjera në ndërkohë.

**Zyra Ligjore** vëren dhe konsideron se dokumenti në fjalë përmbanë teknikisht të gjitha atributet e rregulloreve të punës (punëve specifike), gjithashtu gjuha e përdorur ka përmbajtje të referueshme sikurse dhe teksti i organizuar.

Ndërkaq, organizimi i tekstit, vërehet se nuk është i përcjellë me numërizime referuese në pjesën e Anekseve, prandaj për të qenë tekst i referuar juridikisht, konsiderojmë se është e nevojshme të përmirësohet. Aneksi ka titujt përkatës, ka paragrafët e renditur me numra referues, mirëpo tek tekstet e ndara me pika, të njëjtat nuk janë të shenjzuar me ndonjë të teknikë të gjuhës juridike. Prandaj, propozojmë që tek pikat në paragrafët me numra, ndarja e tekstit të ndodhë sipas metodës alfabetike/abëcë a), b), c)... dhe kështu teksti në vazhdim jep mundësi citimi juridik dhe profesional.